



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.73

Njësia e Vendosur në Tender Nr.22

KB Gllloboçica Toka në Gllloboçicë

Emri i NSh.-së	N.SH "Gllloboçica" ("Ndërmarrja") Kaçanik (Fi 240/85) Emri alternativ Kooperativa Bujqësore "Gllloboçica";
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	25.06.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi Minimal	1,500 €/ari
Depozita e Ofertës	€ 10,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale
Përshkrimi i Aseteve	
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Qafëshqipja, Komuna e Kaçanikut. Të dhënat e hartës ©2024 Google Shikoni këtë pronë në Google Maps 1 Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore. Aseti për shitje përbëhet nga toka, parcela me nr. P-70917018-00684-4 me kulturë arë e klasës 7, me sipërfaqe prej 6,290m² (62ari 90m²) dhe nga objekti të pakryer me sipërfaqe prej 375,50m², në zonën kadastrale Qafëshqipja, në komunën e Kaçanikut. Aseti i ofruar për shitje është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. Parcela e lartë përmendur ka qasje në rrugë publike të asfaltuar. Ky aset ndodhet në afërsi të fshatit Gllloboçicë, në komunën e Kaçanikut.
Ndërtesat dhe tokat	Në pronën e ofruar për shitje ndodhet ndërtesa pjesërisht e kryer.
Shfrytëzuesit	Aktualisht prona e ofruar për shitje nuk është e dhënë me qira.
Asete tjera	Nuk ka asete tjera që përfshihen në këtë shitje.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje



Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



Raporti i vizitës në terren



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT I VIZITËS NË TEREN

Vizita realizuar nga zyrtari/ët:	Gursel Sherif - Zyrtar i Rastit Fatos Latifi - Zyrtar Kadastral	Nëshkrimi 
NSH-ja:	NSH KB Gllloboçica Kaçanik	
Vendndodhja e asetit /Zona Kadastrale:	ZK Gllloboçicë	
Aseti/et/parcels/t	P- 70917018 – 00684-4	
Raport: mujor/tremujor/i rregullt	Raport tremujor mujor	
Problemi/et i/e identifikuar/a nëse ka (Po/Jo)	PO	
Datë e Vizitës	04.04.2025	

Me datë 04.04.2025 së bashku me Zyrtarin Kadastral e kemi vizituar pronën e NSH Gllloboçica në afërsi të fshatit dhe zonës kadastrale Qafëshqipja në komunën e Kaçanikut. Kjo pronë gjendet në skaj të rrugës në drejtim të qytetit të Tetovës.

Gjendja e pronës e përcaktuar në qartifikatë si dhe në ortofoto është e njëjtë dhe e pa ndryshuar sa i përket kufijve të saj e përcaktuar me GPS të dorës.

Kjo parcelë kadastrale aktualisht është livadh me disa dru dhe çuba në pjesën kufizuese kah rruga e asfaltuar.

Prona nuk është e dhënë me qira dhe nuk ka uzurpim apo ndërtim ilegal, parcela ka qasje në rrugë publike të asfaltuar.

Objekti i kësaj prone është gjysmë i ndërtuar, i mungon kulmi në pjesën e madhe të saj kurse tek pjesa tjetër vërehen dëmtime ku janë hekë dyert dhe dritaret e saj.

Objekti nuk ka përkujdesje apo mirëmbajtje për shkakun se NSH-ja nuk është aktive, nuk ka punëtorë dhe si e tillë është e braktisur.

Afër kufijve të pronës janë druje dhe çuba të ndryshme në pjesën afër rrugës dhe pjesa tjetër e kufijve janë me disa çuba.



Parcela kadastrale me nr. 70917018 – 00684-4 në Zonën Kadastrale Qafëshqipja Kaçanik

Ortofoto dhe fotoja e parcelës



2 nga 2

Informatat dhe Dokumentet e Ofertimit

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059
www.pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës